



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "AbdiToptani" Nr. 1;

E-mail: klsh@klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 626/8Prot.

Tiranë, më 27/12/2019

V E N D I M

Nr. 163, Datë 27.12.2019

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË
"MBI AUDITIMIN FINANCIAR"
për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2018.

Nga auditimi i ushtruar në Universitetin "IsmailQemali", Vlorë, në zbatim të Programit të Auditimit, nr. 626/1, datë 04.09.2019, i ndryshuar me programin nr. 626/4¹, datë 19.09.2019 me objekt "Auditim financiar" për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2018, rezultoi se, sa i takon saktësisë, vërtetësisë dhe besueshmërisë së ndërtimit të pasqyrave financiare nga auditimi u konstatuan anomali materiale për nga vlera dhe konteksti, nga kuadri ligjor dhe rregullator i raportimit financiar në fuqi, dhe për sa më sipër japim opinion të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin financiar", të ushtruar në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, sipas programit të auditimit 626/1, datë 29.05.2019, i ndryshuar me programin nr. 626/4, datë 19.09.2019 për veprimtarinë e institucionit nga data 01.01.2018 deri më 31.12.2018.

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

¹Me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.78, datë 19.09.2019, ky Program auditimi zëvendëson Programin e Auditimit nr. 626/1, datë 04.09.2019, me objekt "Auditim financiar dhe përputhshmërie", në kushtet kur një pjesë e drejtimeve dhe periudhës së auditimit, të parashikuar në programin e auditimit nr. 626/1, datë 04.09.2019, u kufizua pasi dokumentacioni I nevojshëm për realizimin e e plotë të tij, ishte tërhequr nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë dhe nga Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit, Vlorë.

Opinion mbi pasqyrat financiare (I kualifikuar)

Neauditua pasqyrat financiare të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë deri më datë 31.12.2018, të cilat përbëhen nga Pozicioni Financiar, Performanca Financiare, Pasqyra e Fluksit të Arkës, Fondet neto, Investimet e Aktivet Afatgjata si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, përveç efekteve të çështjeve të trajtuara në paragrafin “Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare”, pasqyrat financiare, veprimet përgjatë raportimit financiar si dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me kuadrin e aplikueshëm të raportimit financiar.

Baza për opinionin e kualifikuar mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese, mbi bazën materialitetit të përlogarit, vlerësimit tërisqeve si dhe përcaktimit të kampionit, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar të auditimit**².

Në vijim theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, sa i takon:

- Forcimit të kontrolleve të brendshme që lidhen me procesin e inventarizimit, pasi nga evidencat e marra rezultuan thyerje të kontrolleve përgjatë këtij procesi, duke kufizuar audituesit në dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi shifrat e deklaruara përkëtë zë .

- Forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm që lidhen me mirëadministrimin e aktiveve nëpërmjet hartimit dhe miratimit të rregulloreve të brendshme për menaxhimin e barnave, si aktive specifike dhe të domosdoshme për përmbushjen e misionit të Fakultetit të Bujqësisë dhe atij të Shëndetit Publik. Mungesa e rregulloreve për administrimin e barnave, pjesë e infrastrukturës mësimore ka përbërur subjektin me: (i)risqe të skadencës së mallrave ende pa u përdorur, si dhe (ii)risqe të cilësisë së çënuar si pasojë e mungesës së certifikatës së cilësisë së ilaçeve.

- Planifikimit të saktë të nevojave nga ana e fakulteteve, mungesa e të cilit ka mbartur risqe të cënimit të procesit të mësimdhënies, por edhe të shpenzimeve pa eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve si pasojë e blerjes së materialeve të panevojshme;

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i Universitetit dhe stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

²ISSAI 1705 - Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose, kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Universitetit, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

A. MASA ORGANIZATIVE:

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për kontabilizimin eshpenzimeve, Universiteti nuk ka ndjekur parimin e “të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara”, por atë të “lëvrimit të parasë”, në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.. Konkretisht në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018, zëri “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”/llog.600 si dhe “Kontributet e sigurimeve”/llog. 601 janë kontabilizuar më tepër se totali i pagave referuar listëpagesave mujore të deklaruara dhe më konkretisht:

-**llog. 600** sipas treguesve të listëpagesës paraqitet në shumën 363,865,862 lekëndërsa në pasqyrat financiare paraqitet në shumën 363,865,862 lekëose 3,984,214 lekëmë tepër;

-**llog. 601** sipas listëpagesave paraqitet në shumën52,700,722 lekë ndërsa në pasqyrat financiare paraqitet në shumën 54,032,133 lekë ose 1,331,411 lekë më tepër.

Këto vlera financiare sipas të dhënave i përkasin kategorive të pedagogëve “Të jashtëm” dhe “Të ftuar” të cilëve megjithëseu janë paguar pagat neto me bankë gjatë vitit 2018 nuk janë deklaruar në listë pagesën e periudhës ushtrimore. Rrjedhimisht detyrimet të cilat do të lindin nga kontabilizimi në listëpagesë, nuk janë paguar në buxhetin e shtetit në kohë apo të jenë kontabilizuar si detyrim për tu paguar në Pasiv të pasqyrave Financiare të vitit ushtrimor. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 15-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, të merren masat e nevojshme për kontabilizimin e pagave dhe kontributeve në të njëjtën periudhë me pagesën e kryer dhe eliminimin e deformimeve të treguesve në pasqyrat financiare vjetore.

Në vijimësi

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi, nga verifikimi me zgjedhje në sistemin *E-tax* për rregullsinë e deklarimit të liste pagesave mujore, formular *E-Sig 025-A*, nuk vendosen rigorozisht kodet e punonjësve me muaj të plotë (2/001), atyre të hyrë rishtazi kodi (2/006) dhe të larguarit me kodin (2/007). Po kështu në disa raste evidentohen mospërputhje midis datave të largimit nga puna nëpërmjet formularit *E-Sig 027-A* dhe paraqitjes së ditëve të punës në listëpagesë. Aktualisht llogaritja e pagave për listëpagesën mujore realizohet në format Excel, megjithëse institucioni dispononte kontabilitet të informatizuar për sektorin

buxhetor model *Alfa web buxhetor*, çka rrit riskun për gabime krahasuar me programin e informatizuar megjithëse për implementimin e këtij programi institucioni ka shpenzuar një shumë prej rreth 1,500,000 lekë. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 31-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, të merren masat për plotësimin korrekt të formularëve të ndryshimit të punonjësve dhe listëpagesave mujore të cilat janë baza e përfitimit të vjetërsisë në punë.

Në vijimësi

2.2 Rekomandimi: Nga ana e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, të implementohet plotësisht programi informatik edhe në pjesën personelit dhe pagave.

Brenda datës 31.01.2020

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, megjithëse numri i studentëve gjatë viteve 2014-2018 ka pësuar një rënie me rreth 43% (nga 10,228 studentë në vitin 2014, në 5,783 studentë në vitin 2018), stafi i angazhuar në institucion ka pësuar një rritje me gati 13% krahasuar me vitin 2014 (nga 301 punonjës në 2014, në 340 punonjës në 2018) dhe po të njëjtin trend rritës me rreth 33 përqind kanë patur dhe shpenzimet për personelin. Veç rritjes në vlerë absolute të kostove të personelit, tejkalimi në masë të gjerë (thuajse e plotë) nga ana e stafit akademik të orëve mbingarkesën e normuar me akte ligjore në 217 raste në shumën 37,207,563 lekë është justifikuar vetëm me vetëdeklarimet e përcjella nga fakultetet, ndërkohë nga institucioni nuk rezultojnë verifikime lidhur me këto deklarime nëpërmjet mekanizmave kontrollues si njësia e Auditimit të Brendshëm apo grupeve të punës, mangësi të cilat nuk garantojnë efektivitetin, ekonomikitetin dhe eficiencën e pritshme në përdorimin e fondeve të institucionit, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 3143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, të merren masat për verifikimin e vazhdueshëm të ngarkesave individuale për personelin akademik prej planifikimit, ngarkesave mësimore të kryera në fakt dhe të paraqitura nëpërmjet fakultetit respektiv, dokumentimin dhe produktin e punës kërkimore shkencore si dhe detyrave mbështetëse, kjo për të rritur efektivitetin dhe eficiencën e institucionit si dhe eliminimin e pagesave të panevojshme nga ana e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, edhe pse UV ka pësuar 2 ndryshime strukturore përgjatë vitit 2018 dhe 2019, këto ndryshime nuk janë reflektuar në Rregulloren e Brendshme të Institucionit. UV pas 2 (dy) ristrukturimeve të njëpasnjëshme në strukturë, ka vijuar të operojë pa një kuadër rregullator të miratuar për parashikimin e detyrave dhe përgjegjësive sipas pozicioneve të ristrukturuara të punës, si pasojë e mos azhurnimit të rregullores së vjetër me ndryshimet e reja, në kundërshtim kjo me Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 38 pika d.

Mos reflektimi i këtyre ndryshimeve në Rregullore, rrezikon të mos garantojë ndarjen e qartë të detyrave dhe pozicioneve, rrjedhimisht të çënojë dhe llogaridhënien sipas shkallës hierarkike. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr70-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4.1 Rekomandim:

NA të miratojë grupet e punës për hartimin e Rregullores së Brendshme, ku të reflektohen të gjitha ndryshimet strukturore; si dhe të rishikohen rolet dhe përgjegjësitë sipas pozicioneve/strukturave të reja.

Senati Akademik i UV të vijoje me miratimin e Rregullores së re, hartuar konform Statutit të ri të UV miratuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR) me Urdhërin nr.197 dt.01.04.2019.

Brenda datës 30.02.2020

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, stafi administrativ i UV ka mangësi në trajnime, pasi jo të gjithë punonjësit janë përfshirë në programe trajnimi (përfshirë në personeli akademik). Njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, procedurat e prokurimit publik rezultojnë të dobëta, konfirmuar kjo edhe nga auditimi i dosjeve të personelit si dhe të anëtarëve të komisioneve të prokurimeve, të cilët përgjithësisht rezultuan të mos i jenë nënshtruar trajnimeve për procedurën e prokurimit publik. Përgjatë vitit 2018, për këto dy kategori personeli nuk janë zhvilluar trajnime, në kundërshtim me Ligjin nr.10296 dt.08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e NA”, pika (dh), si dhe neni 52, “Funksionet e Administratorit”, pika (a). *Trajtuar më hollësisht në faqet nr70-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

5.1 Rekomandim: Me qëllim mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional në funksion të forcimit dhe funksionimit të kontrolleve të brendshme, Administratori i UV, në cilësinë e NA, në bashkëpunimin me strukturat përkatëse të marrin masat për planifikimin nevojave të stafit me qëllim hartimin dhe ndjekjen e planit të trajnimit të personelit administrativ në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, prokurimet publike, auditin të brendshëm, dhe fusha të tjera të vlerësuara sipas nevojës. etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1 Gjetje nga auditimi: UV nuk ka regjistër aktivesh kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura, i cili të mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar, në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 «Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Ndër të tjera, kjo ka sjellë edhe pamundësinë e verifikimit të vlerave historike dhe gjithë ndryshimeve (investimeve të bëra në kohë mbi to), të Godinave A dhe B ku prej vitesh ushtron aktivitetin ky universitet. Sa më sipër, kufizon grupin e auditimit në (mos)dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi saktësinë e vlerës kontabël të këtyre asetëve dhe si pasojë edhe të amortizimit të akumuluar ndër vite. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr70-88 dhe 15-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

6.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, me Urdhërin nr. 1, datë 10.09.2018 të administratores, është ngritur Komisioni i Inventarizimit të Aktiveve me 5 anëtarë por pa u cilësuar Kryetari si dhe pa u cilësuar afati I përfundimit të këtij procesi. Procesi i inventarizimit në fakt ka filluar më datë 03.12.2018 (pra rreth 3 muaj me vonë) dhe ka përfunduar më datë 26.12.2018, por tabelat përmbledhëse të inventarëve mbajnë datën 20.02.2018 (pra rreth 5 muaj më vonë). Në dosje nuk gjetëm listat e aktiveve për tu inventarizuar, përgatitur nga Nëpunësi Zbatues, në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë shpenzuese, në kundërshtim me paragrafin 81 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se, lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga Nëpunësi Zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë.

Tabelat e inventarëve janë firmosur vetëm nga grupi I inventarizimit dhe jo edhe nga personat e ngarkuar me përgjegjësi material. Për më tepër që fletët e inventarit të përgatitur nga komisioni nuk përmbajnë në asnjë rast informacion të detajuar lidhur me aktivet. Këto tabela janë përpiluar për zëra total (psh vlera e Godinës A, në total, ose vlera e magazinës), duke mos përmbushur kështu rolin për të cilin ky proces kryhet që është: verifikimi fizik dhe cilësor I gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike duke

krahasuar gjendjen konkrete të aktivitetit me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi material e që përputhen me sektorin e financës.

Në relacionin e inventarizimit relatohet se përgjithësisht gjendja e inventarëve në institucion fizikisht janë sipas kontabilitetit. Janë dëmtuar dhe është lajmëruar firma për t'i riparuar 6 tavolina, furnizim i vitit 2017. Por në asnjë rast nuk pasqyrohet informacioni i detajuar për këta artikuj të dëmtuar. Për më tepër që nga verifikimi fizik që grupi I auditimit bëri në magazinë, konstatoi disa pajisje kompjuterike jo në gjendje pune³, me vlerë të mbetur 3,733,587 lekë për të cilat komisioni në fakt nuk është shprehur.

Inventarizimi i aktiveve si një element i rëndësishëm i kontrollit në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë shpenzuese, që kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre, **nuk** është marrë me seriozitetin e duhur nga nëpunësit e përfshirë në proces, dhe është kryer në mënyrë formale duke mbartur riskun që këto aktive të mos jenë verifikuar fizikisht një nga një dhe krahasuar po në të njëjtën mënyrë me fletët kontabël përkatëse, si dhe të jenë konfirmuar edhe nga personat përgjegjës. Për këtë, grupi I auditimit nuk jep dot siguri të arsyeshme mbi saktësinë e vlerës së invnetareve, të pasqyruar në pasqyrat financiare
Trajtuar më hollësisht në faqet nr 66-68, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6.1 Rekomandim:

Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësin Zbatues të marrin masa për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim institucioni, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë. Në veçanti për aktivet e qëndrueshme (Godina A dhe B), Administratori i UV në cilësinë e NA të marrin masat për ngritjen e një komisioni për verifikimin e saktësisë së vlerës së tyre, regjistrimin e saj në pasqyrat financiare dhe mbartjen korrekte qysh prej fillimit të aktivitetit të këtij Institucioni me VKM nr.105 dt.28.03.1994 dhe plotësuar me VKM nr.410 dt.22.08.1994.

Brenda datës 31.01.2020

6.2 Rekomandimi: Përsa më sipër nevojitet që Nëpunësi Autorizues të marr masa për të rikrijuar një komision për inventarizimin e aktiveve, i cili në përfundim të procesit duhet të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të tyre, vlerësimin paraprak *lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes, gjendjen fizike* dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe *personat përgjegjës*.

Brenda datës 30.01.2020

7.Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezultoi se, për menaxhimin e mësim-dhënies, stafi pedagogjik dhe studentor përdorin aplikacionin web UVMS, i cili është një sistem i integruar në faqen zyrtare të Universitetit të Vlorës, www.univlora.edu.al. Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion, rezultoi se ky sistemi UVMS (*Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Mësimor të Universitetit të Vlorës*) është platformë dixhitale krijuar dhe menaxhuar nga stafi IT i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave të UV (sot Sektori IT) dhe miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.101 dt.06.12.2017. Ndër të tjera, ky sistem mban në formë të elektronike regjistrin themeltar të studentëve; regjistrin e arritjeve akademike ku hyn procesverbali i cdo provimi apo detyrimi tjetër akademik; si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.

Nga auditimi rezultoi se, serveri i faqes së internetit me të cilin lidhet ky sistem, nuk ka certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm, pasi portali web i UV nuk përdor një lidhje të sigurte(connectionsecurity) HTTPS, që do të thotë se, në

³Paraqitur me fotonëAnkesin 1

mungesë të kësaj certifikate ekziston risku për humbjen e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali, duke rrezikuar të dhënat që mbart sistemi UVMS.

Gjithashtu rezultoi se, UV nuk ka një bazë rregullatore për aplikacionin e vendosur në web. Procedura e korrigjimit të të dhënave apo të riformulimit të një informacioni për Sistemin UVMS dhënë nga përdoruesi, nuk jep siguri pasi filtri i kësaj procedure nuk ka shtrirje vertikale apo horizontale që të jetë i sigurt: [**pedagog** <-> **dekan**].

Në përfundim siguria dhe vazhdimësia e punës së faqes web: www.univlora.edu.al si dhe aplikacionin web të integruar në të, janë cënuar nga:

- Mbajtja e faqes dhe aplikacionit në serverat e një kompanie pa një kontratë të nënshkruar midis palëve;

- Mbajtja e Back-up të faqes dhe të aplikacionit në të njëjtin ambient me to.

Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 70-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7.1 Rekomandimi: Me zhvillimin e teknologjive të informacionit (TI) dhe zbatimin e tyre në gjenerimin, përpunimin, qarkullimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në njësitë e sektorit publik, është e domosdoshme të merret parasysh nevoja e parashikimit të aktiviteteve të kontrollit të posaçme lidhur me funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të TI-së.

-Në kushtet kur sistemet e informacionit janë element i rëndësishëm i kontroleve të brendshme, veçanërisht në rastin e Universitetit ku serveri menaxhon të dhëna që lidhen me procesin e mësimdhënies, që është dhe aktiviteti primar i këtij institucioni, me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave, në funksion të mirëmenaxhimit të tij, të marren masa për të rikonfiguruar web server-in dhe përdorur protokoll të sigurve HTTPS, i cili kodon komunikimin ndërmjet webbrowsersit dhe serverit.

7.2 Rekomandimi:Strukturat drejtuese të UV të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullatore të Teknologjisë së Informacionit, ku te përcaktohen qartë ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup etj.

7.3 Rekomandimi:Të studiohet mundësia për të ri-dimensionuar “modulin e korrigjimit” duke kaluar kontrolli i procedurave edhe nga administratori i UVMS

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë dhe rregullshmërinë e shpenzimeve për dietat brenda vendit, për trajnime dhe konferenca, në thujtje të gjitha praktikave që shoqëronin urdhër shpenzimet përkatëse rezultoi se: nuk bashkëngjitej produkti përfundimtar (raport/informacion mbi seminarin, trajnimin, etj), si dhe mungonin ftesat nga organizatorët, ne kundërshtim me kërkesat e Vendimit nr. 329, datë 20.04.2016. Në disa dosje nuk gjetëm dokumente që të përmbanin të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, apo personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, I ndryshuar. Në disa raste likuidimi i fondeve është bërë në mungesë të: një dokumenti të plotë autorizues, pasi autorizimi i titullarit nuk specifikon se cili është qëllimi i udhëtimit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr44-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

8.1 Rekomandimi: Në të gjitha rastet në vijim, sektori i Financës të mos bëjë asnjë likuidim sa i takon shpenzimeve të dietëve, pa u plotësuar praktika e shpenzimit me dokumentat autorizues që të autorizojnë kryerjen e veprimit të caktuar ekonomik, dokumentet vërtetues, që të vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimit ekonomik.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në dhjetor 2018, nga UV janë likuiduar 2 fatura për blerje medikamentesh dhe pajisje mjekësore ne shumat 1,000 mijë lekë dhe 2,413 mijë lekë, blerë të “...Farma”, në bazë të kontratës nr. 1027/23, datë 19.12.2018. Kërkesa për blerje medikamentesh dhe pajisjesh mjekësore është parashikuar në buxhet, si pasojë e kërkesave respektive nga departamentet e Fakultetit të Biologjisë dhe atij të Shëndetit Publik.

Nga auditimi rezultoi se:

-Në kontratën nr. 1027/23, datë 19.12.2018, nuk specifikohet me nen të veçantë minimumi i kërkuar i datës së skadencës së medikamenteve dhe/ose lëndës së parë, si një element që i shërben rritjes së efektivitetit dhe eficiencës për përdorimin e tyre.

Gjithashtu komisioni i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 1027/24, datë 19.12.2018 për marrjen në dorëzim të mallit, nuk shprehet në asnjë rast, për skadencat faktike të mallrave, duke rrezikuar kështu blerjen medikamentesh me skadencia të afërta dhe si pasojë nxjerrjen e tyre jashtë përdorimi, ende pa u përdorur, duke i shkaktuar buxhetit të UV, dëm ekonomik.

- Në komisionin e marrjes në dorëzim, nuk ka asnjë specialist të fushës që të shprehet mbi certifikatat e cilësisë së ilaçeve dhe lëndës së parë mjekësore, si dhe gjendjes fizike së tyre. Ky Komision përbëhej nga anëtarët: **I.K., A.H. dhe D.K.**, nga ku një nga anëtarët ishte edhe magazinieri i cili nuk duhet të ishte pjesë e këtij komisioni, në kundërshtim me sa dikton Udhëzimi nr. 30, datë 26.12.2011.

- Nga kryqëzimi i informacionit me fletëhyrjet – fletëdaljet nga magazina, me likuidimet si dhe verifikimin e gjendjes faktike për këto artikuj në magazinë rezultoi se: këto artikuj, edhe pse blerë në kushte emergjence, në fakt akoma nuk janë shpërndarë nëpër fakultete për të përmbushur qëllimin për të cilin edhe u blenë (që prej datës 27.12.2018 qëndrojnë të pa sistemuara në magazinë). *Trajtuar më hollësisht në faqet nr44-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

9.1 Rekomandimi: Në të gjitha rastet e ngjashmet për blerje medikamentesh dhe pajisjesh mjekësore për qëllime mësimdhënieje, në mënyrë që tërisqet të mbahen brenda kufijve të pranueshëm, në vijim:

-të tregohet kujdes nga fakultetet respektive, në planifikimin e nevojave duke argumentuar rast pas rasti limitet e propozuara; si dhe

- gjatë hartimit të kontratave, të shtohet nen i veçantë data e skadencës mbi një limit të gjykuar në bazë të nevojës së përdorimit të artikujve në fjalë;

9.2 Rekomandimi: Në Komisionet e marrjes në dorëzim, të përfshihen specialistë të fushës (nga fakultetet përkatëse) që të mund të shprehen mbi certifikatat e cilësisë së ilaçeve dhe lëndës së parë mjekësore, si dhe gjendjes fizike së tyre.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi:

Grupi i auditimit verifikoi dokumentacionin e administruar nga Universiteti “Ismail Qemali”. Vlore, lidhur me ankesën e një grupi pedagogëshprotokolluar me tonën me nr. 848Prot, datë 23.10.2019, sa i takon rregullshmërisë së pagesës në referencë të titujve akademikë për 6 persona, anëtarë të stafit akademik.

- Nga auditimi rezultoi se, Këshilli i Profesorëve ka miratuar titujt “Prof. As” më datë 21.08.2009, pra rreth 7 muaj përpara se Universitetit “Ismail Qemali”, t’i njihej ligjërisht e drejta (sipas VKM nr. 91, datë 10.02.2010), dhe këta tituj janë njohur dhe regjistruar nga MAS më datë 12.02.2010. Për pagesat për titujt e 6 pedagogë që kanë filluar përpara datës 12.02.2010, është shprehur edhe KLSH, në Raportin përfundimtar tëauditimit me 82/7, datë 20.10.2011, në bazë të të cilit ka dalëUrdhri nr. 80, datë 30.11.2011, i Rektorit të Universitetit, ku Rektori urdhëron shlyerjen e detyrimit financiar për sa më sipër.

Nga auditimi rezultoi se pagesat për 6 punonjësit objekt i ankesës, janë likuiduar duke e ndalur nga pagat përkatëse, në bazë tënjoftimeve përkatëse për shpërblim dëmi më datë 04.11.2011, respektivisht me nr. 80/25, nr 80/27, nr. 80/28, nr. 80/29, dhe nr. 80/30.

- Gjithashtu mbështetur në ISSAI 1610, grupi i auditimit mori në konsideratë raportin e MASR dërguar me shkresën nr. 47 datë 14.06.2019, për verifikimin e ankesës të depozituar në Platformën e Bashkëqeverisjes nga një grup studentësh të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë ku citohet se, *lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e anëtarëve të stafit akademik, të cilët kanë fituar titullit “Prof. Asoc” në Universitetin “IsmailQemali”, Vlorë, rezultoi se, jo në të gjitha rastet janë përmbushur kriteret dhe procedurat për dhënien e titullit,përcaktuar në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2 të VKM nr. 467, datë 18.07.2007 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për kualifikim shkencor e pedagogjik të personelit akademik”.* Për sa më sipër, MASR ka rekomanduar që Universitetin , të ngrrejë një komision “AdHoc”, i cili të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së dosjeve të personelit akademik që kanë fituar titullin “Prof. As” dhe të raportojë gjetjet pranë MASR. Me Urdhrin nr. 48, datë 02.07.2019 është ngritur komisioni Ad-Hoc, por nga shqyrtimi i veprimtarisë së tij konkluduar se materiali i përgatitur prej këtij grupi nuk përmban asnjë vlerësim mbi dosjet akademike përveç se citon se çfarë ndodhet në brendësi të tyre, për secilin punonjës (pra një inventarizim i dosjeve dhe jo vlerësim cilësor i tyre, sikundër kërkohet).Trajtuar më hollësisht në faqet nr88-93,, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10.1 Rekomandimi:Në përmbushje të sa më sipër, Komisioni Ad- Hoc i ngritur nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë të vlerësojë dhe të shprehet në një material të dedikuar, mbi ligjshmërinë e kriterëve dhe procedurave për dhënien e titullit“Prof. As” për 6 punonjësit e cilësuar në këtë ankesë.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin që MASR ka nisur tashmë një procedurë vlerësimi dhe auditimi për problematikat e sipërcituara, kërkohet që në përfundim të gjithë procesit, raporti i detajuar t’i bëhet me dije edhe KLSH-së duke qenë se buron dhe lidhet me zbatimin e rekomandimeve të kësaj të fundit, për vitin 2011.

Brenda datës 30.01.2020

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:Referuar VKM nr. 418, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës të shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore”, numri maksimal i pagesave/mbledhje, për çdo anëtar senati është 9.

Nga auditimi rezultoi se, për periudhën janar-tetor 2018, janë likuiduar anëtarët e Senatit për 1 mbledhje më tepër , në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.06.2012, duke shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e institucionit, në shumën 168,000 lekë.Trajtuar më hollësisht në faqet nr50-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1 Rekomandimi:

- Të merren masa për zhdëmtimin e dëmit në shumën 168,000 lekë si pasojë e pagesës së anëtarëve të Senatit Akademik për 10 mbledhje nga 9 që parashikonte VKM nr. 418, datë 27.06.2012.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018 janë realizuar nga Bordi i Administrimit 17 mbledhje, dhe janë likuiduar 12. Nga shqyrtimi i urdhër shpenzimeve mbi likuidimet e bordit, rezultoi se si pasojë e miratimit të pagesave/anëtar **më tepër** nga sa parashikuar në VKM nr. 418, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës të shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore”, për vitin 2018 janë likuiduar **2,209 mijë lekë** më shumë.

Konkretisht prej datës 01.01.2018 deri në datën 31.10.2018⁴, në përputhje me Vendimin e Bordit Administrativ (VBA) nr. 11, datë 18.05.2017, janë shpërblyer anëtarët në shumën 30,000 mijë lekë/anëtar dhe 40,000/kryetarin, në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës të shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore” ku sipas lidhjes nr.1 këshilli administrativ (sot bordi) shpërblehej me 8,000 lekë/ mbledhje. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 50-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Ndonëse ligji nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” i jep universiteteve autonomi, e cila patjetër kushtëzohet nga burimi i të ardhurave dhe në kushtet kur, për realizimin e misionit të tij, ky universitet financohet nga buxheti i shtetit me rreth 68% të fondeve⁵, ai nuk mundet të caktojë në mënyre krejtësisht të pavarur, masat e shpërblimit, pa u mbështetur në dispozita të tjera nënligjore që rregullojnë ekzekutimin dhe mirë administrimin e buxhetit të institucioneve buxhetore. Në këto kushte, nevojitet që Bordi i Administrimit të rishikojë menjëherë masën e shpërblimit mujor për anëtarët e Senatit Akademik duke e reduktuar atë brenda kufirit maksimal të parashikuar në VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave dhe bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”.

Nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të merren masa që të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 2,209.000 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve administrative, rezultoi se me urdhër shpenzimin nr. 239, datë 27.06.2018, janë likuiduar fonde për “....-SIGURACION” - sha, në shumën 789,000 lekë “Për sigurimin e ndërtesave”, ku vihet re se sigurimi mbulon:

-sigurimin nga zjarri në vlerën 591,460 lekë; dhe

-sigurimin nga vjedhja në shumën 197,540 lekë.

Ajo që vihet re është se, shërbimin nga vjedhja njëkohësisht e mbulon siguria fizike e ofruar nga shoqëria “S....” - shpk, në bazë të kontratës nr. 92/7, datë 01.02.2018, lidhur mes universitetit dhe shoqërisë, e cila ofron sigurimin dhe ruajtjen e godinës me roje. Për këtë shërbim, UV për vitin 2018, ka likuiduar shumën prej 6,121,724 lekë. Sa më sipër nuk justifikon edhe shpenzimin e kryer jo me eficiencë, **prej 197,540 lekë**, për sigurimin nga vjedhja nga kompania “....-SIGURACION” - sha, në kushtet kur ky shërbim aktualisht mbulohet nga shoqëria “S....” - shpk. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 44-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Në vijimësi të mos mbulohet më asnjë shpenzim për sigurimin nga vjedhja për sa kohë që siguria fizike e universitetit, përfshirë edhe mbrojtjen nga vjedhja mbulohet nga shoqëria e sigurisë fizike.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i urdhër shpenzimeve të vitit 2018 për shpërblimet e Senatit Akademik, rezultoi se nga krahasimi i shpërblimit faktik me shpërblimin e

⁴Me miratimin e VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave dhe bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”, VKM NR 418, datë 27.06.2012 u shfuqizua. Aktualisht kufiri maksimal i shpërblimit është 25,000 lekë.

⁵356,214 mijë lekë grant nga buxheti i shtetit dhe 170,561 ijë lekë ngatë ardhurat dytësore)

parashikuar sipas VKM nr. 418, datë 27.06.2012, për periudhën janar-gusht 2018, janë paguar anëtarët e Senatit në masën **5,109,000 lekë më shumë**, në kundërshtim me bazën ligjore e sipërcituar. Konkretisht prej datës 01.01.2018 deri më datë 28.02.2019 ka qenë në fuqi VBA nr. 12, datë 18.05.2017, ku është përcaktuar si masë shpërblimi mujor për anëtarët e Senatit Akademik, shuma prej 35,000 lekë, për Kryetarin ndërsa për anëtarët, shuma mujore prej 30,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës të shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore” ku sipas lidhjes nr.1 senati administrativ shpërblehet me 8,000 lekë/mbledhje, pa bërë kurrfarë diferencimi për shpërblimin e Kryetarit ndaj anëtarëve (pra 28,000 lekë më pak për Kryetarin dhe 22,000 lekë më pak për anëtarët, nga sa rezultoi nga shpërblimet faktike të Senatit). Në kushtet kur kjo pagesë është sistemuar duke filluar nga muaji shtator 2018 e në vazhdim duke u reduktuar në 8,000 lekë, sikundër e parashikon VKM nr. 418, datë 27.06.2012, KLSH konstaton shumën prej 5,109,000 lekësh si menaxhim jo-efektiv fondesh, ndërsa rekomandimin për reduktimin e tarifës në 8,000 lekë e konsideron të zbatuar. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr54-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

D. MASA DISIPLINORE E ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, Rregullores si dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, referuar përshkrimin të punës dhe detyrave që mbulojnë në strukturat përkatëse, i rekomandojmë Bordit të Administrimit dhe Rektorit të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë: të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë marrjen e masave për personat që vlerësohen me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar.

E. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra dhe për zbatimin e rekomandimeve, të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

K R Y E T A R I

Bujar LESKAJ

Konceptoi: A. Jonuzi
Pranoi: B. Arizaj